

Përmbledhje – Jo Teknike



Aktiviteti: “ Prodhim betoni dhe elementeve prej betoni si dhe dhe fraksionim inertesh” të Subjektit LLUCA sh.p.k

Elbasan Perparim Fatish Ndertesa prane kantierit te prodhimit te materialeve inerte.



Përshkrimi i instalimit.

Shoqëria "LLUCA" Sh.p.k. me Administrator Z.Naim LLUCA, vendosi të fillojë këtë aktivitet pasi trualli është në pronësi të Z.Naim LLuca, i cili ka shërbyer si shesh ndërtimi për Linjat e Prodhimit të Betonit e elementeve prej betonisi dhe te fraksionimit te inerteve.

Shoqëria ka si objekt kryesor të aktivitetit te saj prodhimin e betonit dhe fraksionimin e inerteve per lende për ndërtimi.

Cikli i punës do të jetë **me një ndërresë 8 orëshe/ditë** dhe parashikohet të punohet rreth **264 ditë/vit.**

Shoqëria "Luca" sh.p.k vendosi të fillojë këtë aktivitet në këtë zonë pasi:

Vendi i zgjedhur ka këto përparësi:

- Trualli ku ushtrohet aktiviteti është në pronësi të vet administratorit.
- Ndodhet jashtë zonës së banuar dhe vijave të verdha
- Nuk ka probleme sociale e mjedisore
- Ka infrastrukture pothuaj të gatshme

Kufizimet e objektit

- | | |
|------------------------------|----------------|
| • Nga veriu kufizohet me | prone private. |
| • Nga Jugu kufizohet me | prone private. |
| • Nga lindja kufizohet me | prone private. |
| • Nga perëndimi kufizohet me | rruga hyrese. |

Vendodhja e projektit.



Kordinatat e aktivitetit.

Pika	Y	X
1	4398051.691	4545402.420
2	4398047.459	4545436.355
3	4398064.428	4545450.864
4	4398095.253	4545428.106
5	4398071.752	4545393.508

Pershkrimi i sistemit te fraksionimit .

Lenda e para qe perbehet nga inertet shkembore. Inertet sigurohen nga subjekte private.

Per zgjedhjen e sistemit qe do te perdoret per shfrytezimin e objektit kemi pasur parasysh keto faktore:

- Menyra e trasportit te materialit dhe sterilite.
- Menyra e kryrjes se punimeve per perpunimin dhe seleksjonimin e tij.

Tipet e mjeteve dhe mekanizmave qe parashikohen per ngarkim dhe transport.

Shoqeria ka parashikuar qe ngarkimi i mjeteve me materialin e perpunuar te behet me mjet ngarkimi me kove (tip rusp) me sistem e ecje me goma dhe kapacitet kove 1.5m³.

Njesite e sherbimeve mbeshtetese:

Mjete e transportit(makina vetshkarkuese, fodroma, eskavator) kabina elektrike, magazine, etj.

Proçesi teknologjik i prodhimit dhe karakteristikat e tij.

Impianti i fraksionimit dhe proçesi i perpunimit te materialit inert.

Shoqeria “LLUCA”sh.p.k. ka investuar per aplikimin e nje teknologjie bashkekohore te standarteve europiane te prodhimit. Ky impiant eshte teper eficient persa i takon perdorimit te energjise, pjese teknologjike te ndryshme te saj ndertohen ose modifikohen me te reja, shpikje te reja inxhinjerike te cilat permiresojne eficencen dhe optimizojne perdorimin e energjise dhe ndikimin e tij ne mjedis. Kjo linje teknologjike sipas proçeseve qe realizon perbehet nga keto njesi baze:

Sheshi i depozitimit te inerteve eshte ndertuar sipas projektit ne kuoten e bunkereve te favorizuar nga relievi. Ne nyje te ndryshme sipas kushteve konkrete ky shesh mund te jete ne formen e nje rampe.

Sheshi eshte i betonuar qe te mos ndoten inertet qe depozitohen dhe sherben per shkarkimin direkt te makinave te inerteve ne bunkeret perkates dhe per te depozituar rezervat e inerteve per disa dite pune, qe te mos pengohet prodhimi ne rastet kur nuk sigurohet lenda e pare nga nyja e inerteve ne raste difektesh te tyre.

Inertet e depozituara ne shesh, ne kuoten e siperme te bunkereve, hidhen nga makinat ose fadromi ne bunker. Ne keto kushte siperfaqja e sheshit duhet te kete madhesi te mjaftueshem per rezerven e duhur ne rere , granil 1, granil 2. dhe fadroma te levize lirshem ne territorin e bunkereve.

Inertet e depozituara ne shesh hidhen ne bunker me fadrome sipas receptures se percaktuar nga teknologu.



Bunkeri i depozitimit te materialeve inerteve qe vijne nga furnitoret.

Bunkeri është edhe stacioni i parë i materialit inert i cili i nënshtrohet një numri të caktuar procesesh. Materiali inert që depozitohet këtu do të jetë gjithmone në gjendje të lagur pasi do të sperkatet me ujë për efekt të eliminimit të çlirimit të pluhurave gjatë procesit të thyerjes së tij. Bunkeri i depozitimit ka formën e një hinke me fund nga sipër, një kapacitet volumetrik relativ prej 5m^3 , i ndërtuar prej metali çeliku me diametër flete prej 0.8 mm bunkeri është tepër rezistent ndaj forcave mekanike. Në bunker shkarkohet materiali inertë i cili nëpërmjet forcës tërheqëse gravitacionale drejtohet në sistemin e sitosjes.

Skema teknologjike

Transportier me rryp gome që shërben për transportin e materialit.

Sita që shërben për ndarjen e fraksionit mbi 2cm

Transportier me rryp gome që shërben për transportin e materialit nën 2cm.

Sita nr.2 me fuqi që shërben për ndarjen e inerteve në fraksione rere dhe granil "1" dhe "2".

Transportier me rryp gome, cope tre me permasa që shërben për levizjen në shesh depozitimi të reres, granilit "1" dhe "2"

Sitosja e lendes së parë në siten me dy kate

Nga bunkeri ushqyes nëpërmjet një transportieri, lenda e parë i nënshtrohet një procesi paraprak të sitosjes në siten me sipërfaqe prej 2m^2 nga ku largohen fraksionet e trasha nga ato të imtat. Materialet e imta që përfaqësojnë një pjesë të rërës dhe mbetjeve të pa dëshirueshme që shoqërojnë lenden e parë dalin në pjesën e poshtme të sites nga ku largohen në vendet e caktuara për depozitimin e tyre.

Pjesa e materialit të trashë që mbetet në pjesën e sipërme të sites, nëpërmjet transportierit, kalohet për copetim në fronton.

Copetimi i materialit inert në fronto.


Është njësi agregate e dyte e procesimit të copetimit të materialit inert. Frontoja është një pajisje e cila ka një bunker të vogël për futjen e lendes inerte dhe dy nofulla të fuqishme të përbera nga material special që nëpërmjet levizjes së tyre realizohet copetimi i materialit. Materiali tashme i copetuar në fronto që vihet në levizje nga një motorr 5.5 kW, nëpërmjet transportierit kalohet në procesin tjetër të sitosjes.

Fraksionimi i materialit nëpërmjet sistemit të sitosjes.

Pas procesit të copetimit të materialit në fronto, kuptohet që tashme materiali i dalë nga frontoja ka në përberje të tij një përzierje granulometrike nga materiale inertë deri në copeza të mëdha me dimensjone deri në 5 cm. Për ndarjen e këtyre fraksioneve materiali kalon në një site me dy kate

me sipërfaqe 8 m² ku pjesa e imet që del nga pjesa e poshteme e sites dhe që përfaqëson materialin me karakteristikat e reres, kalon në një larese rere ku realizohet procesi i larjes së tij dhe me tëje nepermjet një transportieri kalon në vend grumbullimit të reres, ku trajtohet si produkt i gatshëm së bashku me reren e marrë gjatë procesit (natyrale).

Pjesa mbi site që përbehet nga material i trashë, nepermjet transportierit kalohet në procesin e grimitimit (coptimit) në mullinj.



Proçesi i therrimit s

Materiali i dalë sipër sites nepermjet transportierit kalon në procesin e grirjes në mullinjtë të cilët janë të vendosur në seri për të realizuar një proces sa më të plotë të therrimit të materialit inert. Pasi materialit therrmohet në mullinjtë, nepermjet transportierit kalon perseri në një proces sitosje.

Proçesi sitosjes pas bluarjes së materialit në mullinj

Materiali i bluar në mullinj tashmë i nënshtrohet një procesi të sitosjes në një site me dy kate me sipërfaqe 6 m². Nga ky proces fitohen dy fraksjone që përfaqësohen nga pluhra tëper të imeta dhe pluhura të imeta që nepermjet transportierëve dhe depozitohen në vend depozitimit të tyre të gatshëm për tregëtim. Pjesa e tjetër e materialit që mbetet mbi site nepermjet transportierit kalon në një proces tjetër sitosje që realizohet nepermjet sites që është perseri një site me dy kate dhe në të cilën realizohet fraksjonimi i 5 fraksjoneve që janë fraksjonet mbi 10 mm të cilat nepermjet transportierit riciklohen për në sistemin e bluarjes së perseritur në mullinj, fraksjonet deri në 10 mm të cilat nepermjet transportierit depozitohen në vend depozitim për shitje, fraksjonet nga 5-8 mm që nepermjet transportierit, depozitohen në vend depozitim për shitje, fraksjonet 2-3 mm që nepermjet transportierit kalohen në vend depozitim për tu shitur.

Duhet të theksohet se të gjithë proceset e sipërpervendura gjithmone shoqerohen me lagje me ujë. Për çdo proces uji dërgohet nepermjet një pompe presjoni që ka një prurje prej $Q = 4 \text{ m}^3/\text{min}$ dhe presion optimal të punës 12 ata.

Materiale e seleksionuara depozitohen ne sheshin perkates sipas granulometrise te pershkruar me siper per tre fraksionet rere 0-5, granil 1 dhe 2..

KARAKTERISTIKAT E LINJES DHE SKEMA PROCESIT TE PRODHIMIT BETONIT DHE ELEMNETEVE PREJ BETONI.

Betoni është një prodhim i përbërë që fitohet me përzierjen e çimentos, agregatit, ujit dhe eventualisht shtesave të posaçme kimike (aditiveve). Brumi që fitohet nga kjo përzierje, si pasojë e zhvillimit të proceseve fiziko-kimike fillon të lidhë e me kohë edhe të ngurtësohet.

Teknologjia e betonit është shkenca që mirret me prodhimin e betonit në të gjitha fazat e procesit teknologjik të tij që janë:

- Projektimit të përzierjes (recetës).
- Përzierjes (homogjenizimit) të brumit.
- Transportimi i brumit.
- Vuarjes së brumit të betonit ne vepër (në pahi).
- Dendësimin (trusjen,ngjeshjen) së betonit të njomë.
- Mirëmbajtjes së betonit të njomë.

Sic shifet më lartë, betoni përveç që është një material me përbërje komponentale ai kalon edhe në proçese dhe veprime teknologjike specifike të cilat dukshëm mund të ndikojnë në rezultatet përfundimtare të kualitetit të tij. Problemi është edhe më i madhë duke marrë parasyshë se në teknologjinë e prodhimit të betonit marrin pjesë shumë aktore të cilët nuk e kanë nivelin e njejtë profesional, gjë që edhe ma tepër e ndërlikon problemin.

Pra qëllimi i teknologjisë së prodhimit të betonit është që me materiale përbërëse adekuate dhe mjete teknike që i kemi në dispozicion dhe kuadër profesional adekuat të fitohet beton me veti të kërkuara teknologjike gjersa është në gjendje brumore, kurse me karakteristika të domosdoshme teknike në gjendje të ngurtësuar çfarë kërkohen me projektin e konstruksionit, apo me kushte të veçanta teknike. Pra kërkesat që parashtrohen mund të jenë:

- Vetëm Klasa e betonit ($C_{fck}/f_{ck,cube}$), apo

- Klasa e betonit dhe ndonjë veti e posaçme e tij, si.p.sh. Klasa e ekspozitetit, XCi, XSi, XDi, XF_i.

Kualiteti i betonit dhe faktorët e kualitetit

Fjala “**kualiteti i betonit**” paraqet një kuptim relativë jo plotësisht të definuar, sepse ka të bëjë me një kuptim me domethënie mjaftë të gjerë. Shpesh, në praktikë kualiteti i betonit identifikohet me soliditetin e tij në shtypje (kryesisht me Klasën e tij, C). Një përvetësim identifikues i tillë do ta thjeshtonte problemin, mirëpo shtrohet pyetja se në çfarë mase është përmbushë kuptimi i

definicionit mbi kualitetin e betonit, kjo nga arsyeja se soliditeti mekanik (f_{ck}) kryesisht klasa e betonit (C) paraqet vetëm një tregues të kualitetit të betonit por jo edhe të gjitha aspektet tjera kualitative të betonit. Në praktikë, për ndonjë objekt të caktuar nga betoni mund të kërkohen edhe veti dhe karakteristika të tjera, si p.sh. për ndonjë objekt hidroteknik mund të kërkohet papërshkueshmëria nga uji (XDi), apo qëndrueshmëria ndaj ngricave (XFj), apo rezistenca kimike e betonit (XSk) etj. Prandaj në këto raste përveç Klasës së betonit si karakteristik më përfaqësuese e betonit duhet të dëshmojnë edhe vetitë tjera të nevojshme të betonit si p.sh. C25/30, XC2, apo C35/45 XS3 etj.; në këtë mënyrë është definuar në tërësi lloji dhe kualiteti i kërkuar i betonit për rastin konkret

Përveç vetive të betonit të ngurtësuar në kuadër të kuptimit “**kualitet i betonit**” duhet përfshirë edhe vetitë e brumit të betonit sic janë: aftësia e brumit që sa më lehtë të vendoset në vepër e shprehur me t.aq. *Konsistenca e brumit të betonit*, punueshmëria e brumit të betonit (rafshimi sipërfaqësor pa vështërsi), kohezioni, shmangëja e segregimit etj.

Në vetitë e brumit të betonit dhe betonit të ngurtësuar kryesisht ndikojnë këta faktorë:

Lloji, klasa dhe sasia e çimentos ;

Lloji, përbërja granulometrike dhe kokrra maksimale e agregatit;

Pastërtia e agregatit (sasia e thërmëve nën 0.063mm. dhe materiet organike;

Soliditeti mekanik i agregatit;

Kualiteti i ujit me të cilin përgatitet betoni ;

Lloji dhe kualiteti i shtesave kimike në beton (aditivet);

Raporti sasior i pjesëve përbërse të betonit (reçeta e betonit);

Mënyra dhe kohëzgjatja e përzierjes së brumit të betonit ;

Lloji i mjetit transportues dhe largësia e transportit të brumit të betonit ;

Mënyra e hedhjes dhe vendosjes së betonit në vepër (lartësia e hedhjes së betonit në objekt, trashësia e shtresës.

Mjeti dhe efikasiteti i dendësimit (ngjeshjes) së brumit të betonit ;

Mënyra dhe kohëzgjatja e mirëmbajtjes të betonit të njomë në periudhën e ngurtësimit;

Kushtet termo-hidrometrike që mbretrojnë gjatë kryerjes së punimeve të betonit(verës – dimërit).

Përshkrimi i procesit teknologjik të punës.

Materialet inerte qe do te perdoren per prodhimin e betonit sipas klasave te ndryshme do te jene te cilesise se larte dhe konform kushteve te cilesise per keto produkte. Inerti qe do te perdoret eshte paraprakisht i lare. Linja e prodhimit te betonit dhe elementeve prej betoni perbehet nga sheshi i depozitimit te ruajtjes se fraksioneve te granilit dhe reres dhe dy sillose per depozitimimin e çimentos. Sistemi i drejtimit te prodhimit, ndodhet ne nje kabine e cila eshte elektronike me parametra bashkekohore. Markat e betonit prodhohen sipas kushteve teknike teknologjike dhe realizohen ne funksion te kerkesave te subjekteve juridike dhe fizike te bazuara ne projektet e preventivat e hartuara.

Prodhimi i betonit realizohet sipas skemes se me poshtme:

Raporti per te prodhuar beton eshte 1(C):2(R):4(Z-Ca) ndersa uje eshte raporti $u/\zeta=0.6$ pra per nje kapacitet mesatar prej $100\text{m}^3/\text{h}$, arrijme ne perfundimin se ketij impianti do ti duhen rreth 48t cimento, 96t rere, 192t çakell apo zall, ndersa uje rreth $29\text{m}^3/\text{h}$.

Prodhimi – përzierja e betonit

Gjatë prodhimit të betonit, përzierja e komponenteve duhet të bëhet mirë në mënyrë që të fitohet një brum homogjen i betonit. Përveç në raste të veçanta, përzierja e brumit të betonit duhet të bëhet me përzierse automatike, të cilat në bazë të mënyrës së punës mund të jenë: me rrënje të lirë ose me veprim të detyruar. Dozimi i pjesëve përbërëse duhet të bëhet në masë (peshë) e jo në vëllim. Koha optimale e përzierjes është $1\div 3$ min.

Ne lidhje me ngarkimin dhe transportin eshte parashikuar qe pajisjet do te perbehen nga makina ngarkuese, kamion vetshkarkues, etj. Kjo zgjidhje behet per shkak te adaptueshmerise dhe fleksibilitetit te larte qe kane keto lloj pajisje, shkalles se larte te disponueshmerise, si dhe mundesine per ti kombinuar ato per te realizuar punime te ndryshme sipas nevojave te prodhimit. Nevojat per ngarkim percaktohen nga numri i kamionve te nevojshem qe varen nga distanca e transportimit, disponueshmeria per pune e makinave ngarkuese dhe e kamioneve, oret e punes ne dispozicion per dite/turn, etj. Koha ne dispozicion per ngarkim eshte 8 ore/turn ose dite. Koha e nevojshme per nje cikël te plote te makines ngarkuese per te ngarkuar materialin nga pirgu me materiale ne kamion eshte 60 minuta. Koeficienti i mbushjes se koves se makines ngarkuese zakonisht eshte 80%.

Pershkrimi dhe Volumet e Punimeve.

Punimet konsistojne ne transportimin, depozitimimin dhe perpunimin e materialeve inerte per prodhim betoni. Punimet e instalimit konsistojne ne transportimin e paisjeve si sillosa, elektromotorra, elektropompa, transportier, profile te ndarjes se vend-depozitimitt e inerteve, mjete rrethuese, depozita uji, etj.

Skema teknologjike e prodhimit te betoneve.

Prodhimi i betonit eshte nje proces zinxhir qe realizohet ne linjen perkatese teknologjike. Ne baze te makinerive te zgjedhura dhe skemes se zbatuar kjo linje konkuron dhe do te konkuroje denjesisht

ne tregun duke relizuar prodhimin e markave te ndryshme te betonit sipas kerkesave ne teknologjine e ndertimit. Per te patur nje garanci per cilesine e betoneve dhe per mbarevajtjen e aktivitetit subjekti mendon qe ne te ardhme te ngreje nje laboratore per analizen e prodhimeve te kesaj linje .

Lenda e pare, çohet ne bunkeret perkatese per materiale inerte te ndara ne bokse te ndryshem me 4 dimensione : per rere 0-2mm, fraksioni 5- 10mm, fraksionin 10-20mm.

Uji meret me linjet e rregullt me sistem komandimi ku sasia e ujit te nevojshem matet me kontaliter aparat mates se sasis se ujit ne litra.

Kjo linje eshte mjaft e thjeshte. Prej ketej ajo me ane te shnekut tranportohet per te peshuar dhe per tu perzier me lende te tjera (inerte) per te prodhuar marken e betonit te kerkuar nga klientet. Ne pisten e depozitimit te materialeve inerte eshte instaluar nje linje uji per sperkatje per te mos lejuar ngritjen e pluhurave ne ajer.

Transporti i brumit të betonit paraqet një proces teknologjik të rëndësishëm dhe delikat në kuadër të kryerjes së punimeve betonike. Prandaj gjatë transportimit të brumit të betonit duhet patur kujdes në dy gjëra:

- Segregimit (si pasoje e dridhjeve që ndodhin gjatë transportit);
- Ndryshimi i përbërjes së betonit (rrjedhja e qumeshtit (lengut) të çimentos dhe humbja e sasisë së ujit nga avullimi).

Parametër i rëndësishëm gjatë transportit të brumit të betonit në largësi më të madhe paraqet koha (afatet) e lidhjes së çimentos në beton, sidomos gjatë stinës së verës. Si parametër mund të mirret temperatura e betonit p.sh. për :

Tb=5 – 10 °C koha e transportit t 2h ,

Tb=10 – 20 °C koha e transportit t 1.5h,

Tb=20 – 30 °C koha e transportit t 45' .

Vendosja dhe hedhja e betonit në vepër

Gjatë hedhjes së betonit në vepër duhet patur kujdes që ai të vendoset (hudhet) sipas një orari të caktuar në mënyrë që të arrihet “saldimi” në mes betonit paraprak dhe betonit të ri. D.m.th. betonimi duhet të bëhet me anën e a.q. kampadave. Po ashtu duhet patur kujdes që hudhja e betonit mos të bëhet nga lartësia mbi 1.5÷2.0m, sepse vjen deri te segregacioni, ndërsa shtresat e betonit nuk duhet të jenë mbi 60cm për arsye të vibrimit

Ngjeshja apo dendësimi i betonit

Betoni i porsa vendosur në vepër ka mjaftë zbrazëtira, dhe nëse do të lihet të ngurtësohet do të fitohet gjithashtu një beton por me veti të dobëta dhe i segreguar. Prandaj, fill pas vuarjes së betonit në vepër është më se e domosdoshme që ai të ngjeshet ose të dendësohet. Mjetet më efikase për dendësimin e betonit.

Mirëvajtja e betonit të njomë

Për hidratimin optimal të çimentos dhe ngurtësimin e rregullt të betonit, temperatura më e volitshme e ambientit është $15\div 20^{\circ}\text{C}$, ndërsa lagështia relative $\sim 95\%$. Në temperatura më të ulëta dhe në ato negative ngurtësimi i betonit dukshëm ngadalsohet madje edhe ndërpritet, kurse uji në të ngrihet-shkrihet dhe kështu e shkatërron betonin e njomë.

Nga ana tjetër, me rritjen e temperaturës dhe pakësimin e lagështisë natyrore të rrethinës një pjesë e çimentos nuk mund të hidratizohet, prandaj edhe kualiteti i betonit dukshëm bie. Me humbjen e ujit sipërfaqësor, betoni pëson tkurrje të mëdha e me këtë në të paraqiten çarje dhe plasaritje. Prandaj, detyrë e domosdoshme është që të pengohet avullimi apo humbja e ujit nga betoni në fazën e lidhjes dhe në fazën fillestare të ngurtësimit. Mirëmbajtja e betonit në këtë periudhë (së paku 7 ditë) mund të bëhet me ujitje sipërfaqësore (stërpikje), mbulim me letra, thasë, lecka, etj.

Sot, ekzistojnë edhe disa preparate si p.sh. antisol, me të cilat stërpiket sipërfaqja e betonit dhe kështu këto krijojnë një cipë të hollë në formë filmi, i cili pengon avullimin e ujit nga betoni i njomë.

Proçesi i punes i elementeve prej betoni konsiston si me poshte:

Impianti funksionon ne kete menyre: ne bunkerin e furnizimit te inerteve hidhen me kamion inerte te fraksioneve te ndryshme sipas cilesise se kerkuar te produktit. Me pas nepermjet transportiereve ato transportohen per ne mikserin e perzierjes se materialit. Me pas perzihen me çimenton dhe llaçi i gatshem i transmetohet makinerise e cila preson blloqet me llaç gjysem te thate, duke prodhuar blloqet, pllakat e betonit, bordurat dhe elemente te tjere prej betoni. Materiali ngarkohet ne mjetet e renda te transportit nepermjet vinçit, nga kamione vetngarkues-vetshkarkues. Proçesi kryhet me çimento pluhur jo te lengshme, e cila blihet e gatshme, shtohet uje dhe me pas perzihet ne mikser e shkarkohet ne autobetonieret e transportit. Raportet çimento, inerte, uje jane sipas cilesise se kerkuar te betonit.

Krahas tyre eshte ndertuar

1.Sistemi i kanalizimeve dhe parandalimit te ndotjes se mjedisit, puseta dhe kanale mbledhes te ujrave.


2.Sistemi i mbrojtjes kundra zjarrit, fikse zjarri portative, kosha metalike,tabela sinjalizuese, rezervar uji i lidhur me nje pompe qe siguron uje me presjon ne te gjithe ambjentet e punes.

3. Sistemi i rjetit elektrik, telefonik dhe atij hidrik per ushtrimin e veprimtarise.

4. Sistemi rrugor.

Njesite teknike te ketij instalimi jane:

1. Kabina e komandimit te makinerise
2. Bunkeri i furnizimit me inerte
3. Eektromotore per venien ne pune te transportiereve
4. Mikseri i inerteve, rere+granil dhe çimento pluhur (me thase)
5. Sheshi i levizjes se makinerise e cila preson beton ne te thate e stampos blloqet.
6. Makineri per prodhimin e blloqeve
7. Vinçin per ngritjen e ngarkimin e paletave me blloqe betoni e kane vete makinat transportuese.
8. Mjete transportuese tip "Piruna".
9. Makineri per prodhimin e tubave
10. Makineri/Kallepe per derdhjen e betonit per produkte te ndryshme.



Permbledhja tabelore vleresimit te ndikimeve ve mjedis

Nga çka trajtuam me siper, me qellim konformimtet me metodikat zyrtare te vleresimeve te ndikimeve ne mjedis por edhe per nje identifikim me racional te tyre, ne tabelen e meposhtme paraqiten te detajuara efektet negative, vendin ku dhe si ndikojne ato.

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
Ne toke	Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo
Humbje tokes per kullote		X
Ndryshime topografike te terrenit		X
Prishje punime bujqesore		X
Ndotje e tokes nga rrjedhjet		X
Ndotje e tokes nga mbetjet e ngurta		X
Ndotje e tokes nga depoz. llumrave	X	

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
Ne ajer	Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo
Prodhimi i pluhurit		X
Ndotje nga djegia e hidrokarbureve	X	
Ndotje nga CO,SO ₂ ,NOx	X	

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
Ne floren dhe faunen	Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo
Shkaterrim i rendesishem habitateve natyrore		X
Ndertimi i rrugeve te reja qe kalojne ne zonat e virgjera		X
Rrezikimi i nderhyrjes ne bimet e ujit		X
Percarje/izolim habitanteve te egra		X
Interferenca midis rrugeve natyrale te emigrimit te sisoreve		X

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
Ne uje	Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo
Trajtimi i ujrave te ndotur	X	
Ndotja e ujit nga pluhuri,plumbit, derdhje aksidentale te substancave Te tjera		X
Impak sekondare ne ndotje e ujit per tokat bujqesore, ujra n/tokesore etj.		X

Modifikimi ne drenazhimin e ujrave natyrale		X
Ndotja e ujrave siperfaqsove dhe nentokesore nga llumrat		X

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
Nga zhurmat	Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo
Rritja e nivelit egzistue te zhurmave	X	
Rritja e nivelit te zhurmave si rezultat i aktivitetit dhe makinerive	X	
Rritja e nivelit te zhurmave per njerezit		X
Nivel me i larte i zhurmave per kafshet		X

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
Perfitimin e tokes	Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo
Prishje banesash		X
Ndryshime te rendesishme ne programet per te ardhmen e perdorimit te tokes	X	
Ndotje nga CO,SO2,NOx		X
Rivendosje banesash		X
Shpronesime te tokave		X

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
Ne trashegimine kulturore	Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo
Ndryshime apo demtime te zonave arkeologjike apo me vlera historike dhe kulturore		X

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
Ne energji	Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo
Perdorimi ne sasi te medha te karburantit per energji		X

Rritje te rendesishmete kerkesave per burime egzistuese te energjise apo kerkesave per tipe te tjera te energjise		X

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
Ne interesin publik (infrastruktura)	Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo
Zhvillimi i aktivitetit do te kete nevojte ne fushe te interesit publik	X	
Energji elektrike		X
Sistemim i komunikacionit		X
Sistemim i kanaleve te ujrave te zeza e te bardha		X
Sistemim te ujesjellesit		X
Mbetje te ngurta e sistemim te tyre	X	

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
Ne shendetin e njerezve	Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo
Krijimi i cfaredo rreziku apo mundesie per demtimin e shendetit te njerezve		X
Krijimi i raportit te njerezve me rreziqet e mundeshme per demtimin e shendetit te tyre		X

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
Ne qarkullim e transport	Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo
Rritje te rendesishme te qarkullimit e transportit te automjeteve		X
Pakesim te veteqendrimit te automjeteve apo nevojave per vend qendrim te reja		X
Ndikime te rendesishme ne sistemin e komunikacionit		X
Ndryshime ne qarkullim apo te levizjes se njerezve e mallrave		X

Ne kete tabele renditen nje sere kerkesash qe ndihmojne ne vleresimin e nderveprimeve ne mjedis si dhe gjykohet ne se veprimtaria do te kete ndikime potencjale/thelbesore ne elementet perberes te mjedisit.

Ndikimet tek njerezit, ndertesa dhe objektet e ndertuara nga njeriu .

Ndikimet e dukshme te projektit ne zonat rrethuese dhe pejsazhi.

Gjate shfrytezimit te objektit parashikohet regjenerimi hap pas hapi i ambjenteve te punes. Ne vendet e caktuara ne projekt parashikohet depozitimi te materialeve inerte pa perdorim dhe perpunimi i tij me toka vegjetale per te mundesuar mbjelljen bimet e pemet dhe pemeve karakteristike te gjelberuar dhe me shlodhese per syrin.

Ndikimet e projektit te zhvillimit ne rruget lokale dhe transportit.

Sot per sot objekti eshte i lidhur me rrugen nacionale Peqin Rrogozhine me nje rruge dytesore te pashtuar. Ky segment rruge mirembahet dhe do te mirembahet vazhdimisht. Intensiteti i levizjes se makinave te transportit te subjektit ne kete segment nuk do ta rendoje trafikun aktual, kjo per faktin se ne kete segment rrugor parashikohet te levizin pak makina transporti ne dite.

Mjetet e transportit qe jane te tonazhit deri 20ton ton do te sherbejne si mjete levizese per transportin e materialit.

Keto mjete do te jene te nje cilesie te larte dhe nuk do te perbejne asnje problem per komunitetin e kesaj zone (sepse eshte mjaft larg pothuajse 2km).

Ndikimet e projektit mbi ndertimet, trashegimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike si dhe mbi vepra te tjera njerezore

Si rezultat i zbatimit te projektit ne kete zone nuk ka ndikim negativ mbi ndertimet, trashegimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike dhe mbi vepra te tjera njerezore, sepse ne kete zone dhe perreth saj nuk ka asnje objekt te nje rendesie te vecante te karaktereve te lartpermendura.

Pershkrimi i ndikimeve negative individuale dhe te grumbulluara ne biodiversitete duke perfshire ndikimet nderkombetar.

Sikunder eshte trajtuar edhe me lart, nga zbatimi ne praktike i projektit te copetimit dhe seleksjonimit te materialeve inerte, ne siperfaqen e ushtuar, nuk ka dhe nuk jane parashikuar ndikime individuale apo te grumbulluara ne biodiversitet.

Objekti eshte ne brendesi te territorit te vendit dhe nuk ka ndikime nderkufitare.

Konsekuenca te tjera ekologjike.

Ushtrimi i aktivitetit te ketij objekti nuk sjell pasoja te tjera ekologjike. Me hollesisht te dhenat konkrete per ndikimin e mundshem ne aspektin mjedisor jane dhene ne paragrafet e vecante, qe flasin per aspekte te vecanta te ndikimit mjedisor.

Ndikime te tjera klimaterike.

Gjate dhe pas ushtrimit te aktivitetit te shfrytezimit, nuk priten ndryshime klimaterike, si ne drejtim te permiresimit ashtu edhe ne ate te perkeqesimit te saj. Pra kryerje e ketij aktiviteti nuk ndikon fare ne kushtet klimaterike te kesaj zone.

Masat zbutese te ndikimeve negative gjate proçesit te shfrytezimit.

Masat zbutese te ndikimeve negative konsistojne ne marrjen e masave per uljen e ndotjeve gjate punimeve te pajisjes se cõptimit, si pluhurat dhe zhurma, si dhe uljen e efekteve negative hapsinore ne territor , faun dhe flore.

Identifikimi i masave per te eleminuar apo zbutur ndikimet negative ne mjedis.

Masat teknike.

Keto masa do te sherbejne si barriera per pluhurat qe mund te çlirohen gjate ushtrimit te aktivitetit gjate aktivitetit.

Uljen e intensitetit te perpunimit per stinen e veres si dhe lagia e terreneve nen pune dhe lagia e materialit qe do te perpunohet, do te evitohet edhe ndotjen gjate prodhimit dhe transportit.

Nderkohe sigurimi i karburanteve per djegie me cilesi te larte dhe me permbajtje te squfurit te vogel do te realizojte nje prodhim pa shume shqetesime per ndotjen e ajrit nga shkarkimet e gazeve te djegies.

Sistemi i mbrojtjes ngaj zjarrit - Sigurimi i jetes se puntoreve dhe investimit nga zjarri realizohet nepermjet nje sere pajisjesh dhe mjetesesh te cilat garantojne neutralizim te shpejte te çdo zjarri te shkaktuar na ambientetet e kantierit. Sistemi i mbrojtjes nga zjarri mund te kategorizohet ne dy njesi funksionale paisjesh dhe instalimesh:

1 – Njesia qendrore e parandalimit dhe shtypjes se elementeve zjarr – venese nepermjet nje sistemi qendror komandues i cili mbeshtetet ne nje depozite uji dhe sistem tubash me presion. Ky sistem lejon shperndarjen e ujit me presion ne hidrante te vendosur ne çdo kend te subjektit.

2 – Njesia e mjeteve te nderhyrjes dhe neutralizimit te perhapjes se zjarrit (dy fikse zjarri e levizshme me shkume 25 l) te vendosura ne ambientet e jashtme te objekteve.

I gjithe personeli qe do te punesohet ne kete aktivitet do te trajnohet nga specialistet perkates te subjektit per menyren e veprimit ne rast aksidentesh, kordinimit te operacioneve dhe nderhyrjes efikase.

Plani i Menaxhimeve te Elementeve me Ndikim ne Njedis

Lidhur me Planin e Menaxhimit te ndikimit ne mjedis Shoqeria “LLUCA” sh.p.k ka nje vizion te qarte, modern dhe realist ne realizimin e zbatimit te ketij plani, fale eksperiences qe ka subjekti me personelin e tij dhe konsultimeve te vazhdueshme me specialiste te ndryshem. Shoqeria e sheh zbatimin e Planit te Menaxhimit te elementeve me ndikim ne mjedis jo vetem si detyrim ligjor dhe moral por si nje pjese e pandare e suksesit te punes se saj ç`ka i jep nje shtyse edhe me te forte ne menaxhimin me sukses te elementeve me ndikim ne mjedis.

C`fare	Si
	<ul style="list-style-type: none">- Perzgjedhja e teknologjise me cikël te mbyllur me pajtueshmeri mjedisore- Instalimi korrekt i makinave, sipas skemes teknologjike te permiresuar- Perzgjedhja dhe trajnim i personelit per menyren e perdorimit te teknologjise dhe veprimit
Parandalim	<ul style="list-style-type: none">- Materialit inert qe do te fraksionohet do te jete gjithmone i lagur dhe fraksionimi do behet ne prani te ujit

	<ul style="list-style-type: none"> - Kontroll i vazhdueshem dhe mirmbajtje se pajisjeve - Sigurimi i sistemit te komandimit te pompave - Perdorimi i naftes D1 per kamionet dhe per kaldajen e impiantit te prodhimit te asfaltit - Zbatim i rigoroz i sigurimit teknik gjate punes dhe nderprerjes se saj - Vezhgim dhe kualidim i vazhdueshem i te gjitha teknologjise se projektit, sistemit te qarkullimit te produktit, etj - Testimi periodik i teknologjise agregateve te saj deri ne nivel detali 	
Kontroll	<ul style="list-style-type: none"> - Sigurimi i te gjitha pajisje te nevojshme per riparim, pastrim dhe nderhyrje ne rast emergjencash - Kompaktesim dhe lagie e inerteve ne qiell te hapur - Lagie e sheshit te punes dhe rrugeve te levizjes se kamioneve ne kantier - Levizje e ngadalte e automjeteve ne kantier dhe jashte tij - Larje e shpeshte e makinerive dhe kamioneve te punes sidomos para se ma dale ne rrugen nacionale - Transporti i inerteve me kamion te mbuluar mbulese me polietilieni 	
Nderhyrje	<ul style="list-style-type: none"> - Riparim i menjehershem i difekteve dhe avarive teknologjike - Aktivizim i menjehershem i stafit dhe mjeteve ne rast emetimesh dhe derdhjesh te pa parashikuara sipas skemes. - Pastrim i menjehershem i derdhjeve aksidentale - Njoftim i menjehershem i autoriteteve dhe njesive te specializuara ne rast emergjencash (zjarrfikes, autoambulanca) 	
Administrim	<ul style="list-style-type: none"> - Perdorimi dhe ruajtja me pergjegjesi i te gjitha infrastruktures dhe makinave sipas skemes dhe rregullave teknologjike. 	

Menaxhimi i mbetjeve ngurta

Administrata dhe punonjesit e kantierit do ti kushtojne vemendje te vecante edhe ketij aspekti per te parandaluar ndotjen ne mjedis nga llumrat qe dalin gjate procesit te larjes se lendes se pare si dhe nga dispersiteti i ambalazheve te ndryshme qe mund te kete etj.

Llumrat e dala qe jane dhera depozitohen ne gropen e dekantimit dhe do te sherbejne per mbushje te tokave qe jane me probleme.

Ne mjediset e kantierit jane vendosur kazane te grumbullimit te mbetjeve te krijuara nga veprimtaria e kantierit. Mbetjet e grumbulluara do te transportohen ne menyre periodike ne vend –depozitimin e qytetit te percaktuar nga pushteti lokal.

Manaxhimi i mbetjeve te lengta.

Mbetjet e lengta jane ujrat qe shkarkohen nga larjet teknologjike te skemes si dhe ato nga impianti i dekantimit dhe pastrimit me flotim te ujit qarkullues. Ujrat e shkarkuara jane brenda normave te lejuara dhe nuk permbajne elemente ose substanca ndotese sepse perdoren vetem per larjen e inerteve qe jane lende natyrore. Uji qe derdhet nga ky perpunim eshte i pastert dhe nuk shkakton ndotje te mjedisit. Shkarkimet e

ujrave te kantierit largohen nga territori i tij pasi kalojne ne gropa dekantmi dhe nepermjet tubave nentokesore kalojne ne kolektorin kryesor.

Menaxhimi i mbetjeve te gazta- nuk ka me perjashtim te gazrave qe leshojne makinat e transportit
Programi i monitorimeve dhe elementet e tij.

Ne pergatitjen e programit te monitorimit specialistet kane marre ne konsiderate mundesine per te realizuar nje monitorim realist te elementeve me ndikim ne mjedis. Persa me siper eshte menduar qe te perzgjidhen per tu monitoruar nga vete kompania ata elemente qe realisht mund te indentifikohen, maten, rregjistrohen dhe komunikohen ne organet e administrimit te mjedisit (AKM-ne, ARM-ne, Bashkine etj). Te dhenat cilesore, sipas tabelës do te hidhen ne nje regjister qe administrohet nga vet kompania dhe do te dorezohen ne AKM dhe ARM-ne e Qarkut sa here ju kerkohet, sipas proçeduarve ligjore dhe rrgulloreve.

Nr	Natyra e monitorimit	Frekuenca	Analiza
1	Monitorimi i zhurmave	Çdo 6 muaj muaj	Normat e lejuara sipas udhezimit nr.8
2	Monitorim parametrave fiziko – kimike i ujit te perdorur para shkarkimit ne lume	Çdo 6 muaj muaj	Analize e plote. Parametrat fizike, temperatura, pH, lenda pezull, COD, percjellshmeria elektrike Norma e Lejuara do te jene sipas VKM Nr.177
3	Matja - Listimi i te gjitha mbeturinave dhe krahasimi me standartet ISO 1990/2000.	Çdo jave	Peshimi dhe asgjesim/riciklimi i tyre
4	Emetimi dhe depozitimi i pluhurit	Periodik	Ne pika te ndryshme brenda dhe jashte kantierti
5	Analiza e mjediseve ku punohet	Periodik	Lageshti, ajrimi, temperatura, pluherat dhe zhurmat
6	e karburanteve dhe detergjenteve qe perdoren	Periodik	Nafta, solari detergjentet dhe kimikatet e tjere

Investitori mirepret çdo sugjerim nga AKM-ja dhe ARM-ja ne lidhje me shtimin e elementeve te monitorimit dhe metodikes se perdorur. Per te realizuar matje sa me te sakta subjekti do te konsultohet me specialiste dhe staf akademik i cili do te sugjeroje instrumenta mates te pershtatshme dhe metodike lehtesisht te perdorshme nga personeli per te bere llogaritjet.

REKOMANDIME.

Nga analiza e tere aspekteve te marre ne shqyrtim ne Permbledhjen e Raportit te V.N.M-se te projektit per ndertimin dhe funksjonimin e linjes per prodhimin e inerteve te ndertimit me baze furnizimi inertet shkembore e lumore nepermjet perpunimit dhe seleksjonimit te tyre si dhe infrastrukturen mbeshtetese te saje(ofiçina etj), zbatimi i projektit nuk do te kete pasoja negative te mateshme ne mjedisin e zones.

- Ndikime minimale do te kete vetem ne ndryshimin e pejsazhit te siperfaqes se shfrytezuar. Me masat qe jane parashikuar te merren, ky fenomen do te zbutet
- Projekti parashikon rehabilitimin e zones krahas ndertimit. Kjo eshte arsya qe subjekti i ben propozimet perkatese dhe dokumentacionin e pregatitur per tu paisur me Leje Mjedisore. Nderkohe eshte me rendesi qe subjekti te kete parasysh keto detyrime gjate fazave te ndryshme te realizimit te projektit.
- Subjekti duhet te respektoje gjate ushtrimit te aktivitetit te gjitha detyrat qe i takojne monitorimeve periodike dhe te beje raportimet prane AKM-se dhe ARM-se sipas afateve te percaktuara per keto monitorime

Duke bere vleresimin permbledhes te raportit te pregatitur, i cili parashton projektin e shfrytezimit te linjes se mesiperme ne zonen e kerkuar, del e nevojeshme te bejme konkluzjone :

- Territori ne fjale nuk ka statusin e parkut kombetar.
- Territori ku eshte montuar dhe ushtrhet aktiviteti ndodhet ne distance relativisht te afert nga shtrati i lumit Shkumbin dhe investimi eshte realizuar ne nje toke te ngjeshur dhe te mbrojtur dhe jo zallishte
- Zbatimi i ketij projekti nuk do te kete ndonje pasoje negative te mateshme ne mjedisin e zones.
- Vendin e siperfaqes se shveshur do ta zere nje siperfaqe e mbjella me drunj dekorative ne pershtatshmeri me floren e zones.
- Hapja e vendeve te reja te punes per zonen.

Përgatiti Raportin;

Naim LLUCA

